**BASHKIA MIRDITË**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3928/3 Prot                                        Rrëshen më, 06.10.2025

# V E N D I M

**Nr. 77 datë 30. 09. 2025**
**PËR**
**"PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE",**
**BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" *i ndryshuar*, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 24.01.2025, "Për miratimin e buxhetit 2025", VKB nr. 115, datë 27.12.2024, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", *relacionin nr. 3928/1 prot, datë 30. 09. 2025, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Z. Danjel Ded Çoku", nga sektori i shërbimit social të bashkisë,* së bashku me projektin e Kryetarit Bashkisë, *shqyrtimin e miratimin në mbledhjen e datës 29.09.2025, të Komisionit Ekonomisë, Financës dhe Buxhetit,* për t'a kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;

## V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, *në shumën 100 000 (njëqind mijë) lekë*, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;

- T'i akordojë ndihmë financiare, Z. Danjel Ded Çoku me ID; K01022024H, qyteti Rubik, njësia administrative Rubik, për kushte të vështira jetese dhe sëmundje pjestare të familjes

   a. **Paksim:** Fondi rezervë; (A1133 00 2133001 01 V491AAA...604) në vlerën;...........**100 000** lekë

   b. **Shtohet:** Pagesë; (AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën;.....................**100 000** lekë

2. Pagesa të kalojë me bordero, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat)

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!*

| S E K R E T A R | K R Y E T A R |
| --- | --- |
| **Gaspër TOPOLLAJ** | **Aleksandër PICAKU** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI ... RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

P/V E N D I M

Nr 3928/2 Prot

Datë 30/09/2025

**Nr. 91 date. 30 9 .2025**

"PËR PERDORIM FOND REZERVE "

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 115/2024, "Per buxhetin e vitit 2025" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.24.01.2025, "Për zbatimin e buxhetit 2025", ,ne VKB nr.115 datë 27.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025", në relacionin, nr.3283/1 prot, datë.30.09.2025, "Mbi vlesimin e situates financiare dhe sociale te z. Daniel Ded Çoku", e sektorit të shërbimit social, Bashkia Mirditë, këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

**V E N D O S I:**

***I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 100000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;***

1.Të japë ndihmë financiare familjes së z. Daniel Ded Çoku, banues, NJA Rubik, për kushtet të vështira jetese dhe semundje pjestare familje.

**a-Paksim**:fondi rezervë ( AI133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën ***100000 lekë***

***b-Shtohet*** (AA133 00 2133001 01 V111AAA......606) për shumën ***100000 lekë***

.2.Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

***II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori e finances dhe buxhetit.***

***III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.***

**SEKRETARI**
**Gaspër TOPOLLAJ**

**KRYETARI**
**Aleksander PICAKU**

**Paraqiten projektin**

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M.Doda

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË – BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a

**BASHKIA MIRDITË**

**AGJENCIA E ARSIMIT SPORTIT DHE NDIHMËS SOCIALE**

Nr.3928/1 Prot. Rrëshen, më 30.09.2025

Lënda: Relacion për mbështetje ekonomike

Drejtuar: Drejtorisë së Financës

Lidhur me kërkesën e ardhur sot me datë 30.09.2025 në Bashkinë Mirditë, drejtuar nga Daniel Ded Çoku, i lindur në Rrëshen, më 22.10.2000, me NID K01022024H, për ndihmë financiare, ju japim relacionin si më poshtë:

Daniel Ded Çoku është banues në Rubik. Ai jeton së bashku me nënën, e cila është e moshuar dhe ka shumë probleme shëndetësore. Danieli është i diagnostikuar me Spina Bifida aperta, Tetraplegji inferiore. Babai, z.Ded Çoku ka ndërruar jetë në fillim të muajit gusht, gjë që përveçse i ka kushtuar dhimbje shumë të madhe familjes, në veçanti Danielit, i cili ka qenë shumë i lidhur me babain e tij, e ka vështirësuar shumë situatën ekonomike dhe sociale të familjes. Babai ka qenë personi që është kujdesur për Danielin, për të gjitha nevojat e tij shëndetësore dhe me mungesën e tij, tani gjithçka është vështirësuar.

Nevojat shëndetësore të Danielit janë të shumta, pasi e tillë është gjendja e tij aktuale, për këtë, si Shërbim Social i Bashkisë Mirditë, e vlerësojmë të domosdoshme akordimin e një mbështetjeje fninanciare për këtë rast.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

Konceptoi: Adela Gjikola

Miratoi: Drejtori Aurel Çupi

Përgjegjës i Sekt.Soc. Gjergj Përgjoni

Drejtuar Këshillit Bashkiak Mirditë Dt. 30.09.2

Unë Daniel Çoku banues në Rubik, po ju drejtohem për mbështetje financiare, si fundmi me datë 1 gusht 2025 jam përballur me nje fatkeqësi, babai im Ded Çoku ka nderruar jetë i cili ishte mbështetja imëmë e madhe si pasoj jemi përballur me shumë shpenzime dhe borxhe të cilat nuk mund ti përballojm dot.
Gjend ime shëndetësore është e vështire pasi jeloj në Karrige me rrota dhe trajtohem me Kemp, paga që ma shpenzohet pothuajse e gjitha për mjekime dhe shpenzime të nevojës higjenosanitarës, pasi e till është diagnoza ime.
Gjithashtu mamaja është e moshuar dhe ka probleme të theksuara shëndetësore dhe jam i detyruar ta dergoj për vizita tek mjekët specialist që të marre kurën e duhur.

Duke ju njohur si institucion që mbështet qytetarët në nevoj, ju lutem të merrni në konsiderat kërkesen time dhe të më mundësoni ndihmën e mundshme financiare.

Me Respekt.

Danie Ded Çoku

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQERORE

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE

Rruga "Frang BARDHI",Lezhë, Tel/Fax: 0215 2142,e-mail: drsshle@yahoo.com;www.issh.gov

VENDIM NR. 221

(Per kontrollin e te semureve Paraplegjik e Tetraplegjik)

Komisioni mjekesor i caktimit te aftesise ne pune i Rajonit ne rrethin e Mirditës ne mbledhjen e dates 18/07/2017 pasi studioi kerkesen dhe dokumentat e te semurit Danjel Ded Coku konstatoi se:
kuadri klinik ______

Analizat dhe ekzaminimet baze ______
Diagnoza Spina Bifida aperta, tetraplegjia inferiori

Mbeshtetur ne dokumentat e paraqitura dhe kriteret mjekesore komisioni

**Vendosi:**

Te caktoje Danjel Ded Coku se ______ eshte ne kushte te grupit te pare
Prej dates 01.07.2017 deri ne daten – per bine –
Afati i rikontrollit ne KMCAP ______
I semuri Danjel Ded Coku ka nevoje per kujdesje te vazhdueshme nga nje pjesetar tjeter.

**Shenim:** Ky vendim merret per efekt te perfitimit nga ligji nr 8626 date 22.06.2000.Per statusin E invalidit paraplegjik e tetraplegjik,te ndryshuar dhe VKM nr 78 date 07.02.2007 per masen. kriteret dhe procedurat e perfitimit te nje pakete te vecante higjeno-sanitare per invalidet Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

| Anetar | Anetar | Anetar | Anetar |
|---|---|---|---|
| Fellenza Taga | Gjovalin Valca | Bardhok Doda | ______ |

Kryetar
Zef Prenga

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQERORE - REPUBLIKA E SHQIPERISE